



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.8367/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen përmbartimore të kreditores F. H nga Komuna e Graçanicës, të cilën e përfaqëson i autorizuari Fadil Sinanaj avokat në Gjilan, kundër debitorit Komuna e Podujevës-Drejtoria për Shëndetësi, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Faik Rama, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, PPP.nr.603/2021 të datës 11.08.2021, me datë 30.12.2021, mori këtë:

AKTVENDIM

PRANOHET si e bazuar, ankesa e debitorit Komuna e Podujevës-Drejtoria e Shëndetësisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, PPP.nr.603/2021 i datës 11.08.2021, PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Arsyetim

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Podujevës, Drejtoria për Shëndetësi, i paraqitur ndaj Urdhrit për përmbartim PPP.nr.585/2020 të datës 15.05.2020.

Kundër aktvendimit të atakuar, ka paraqitur ankesë debitori, pa i përmendur shkaqet, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit Komuna e Podujevës dhe të prishet aktvendimi PPP.nr.603/21 i datës 11.08.2021 dhe të shfuqizohet Urdhri për përmbartim P.nr.585/20, i datës 15.05.2020.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar kreditori, me propozim që Gjykata e Apelit, ta refuzojë si të pabazuar në ligj ankesën e debitorit Komuna e Podujevës-Drejtoria e Shëndetësisë, meqë nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e paraqitura në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me nenin 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit me datë 15.05.2020 te Përmbaruesi Privat A. M në bazë të Vendimit Nr./01-12-88/2019 të datës 21.01.2020 dhe Vendimit Nr./01-12-88/2019 të datës 10.04.2020, duke kërkuar nga përmbaruesi privat që të lejoj përmbarimin për pagesën e borxhit dhe të detyrohet debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së urdhrit, t'ia paguaj kreditorit borxhin prej 1,413.99€.

Përmbaruesi Privat në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka nxjerr urdhër P.nr.585/20, të datës 15.05.2020. me të cilin ka caktuar përmbarimin në bazë të vendimit të MPMS të Inspektoratit të Punës Nr./01-12-88/2019 të datës 21.01.2020 dhe Vendimit Nr./01-12-88/2019 të datës 10.04.2020.

Ndaj urdhrit për caktimin e përmbarimit brenda afatit të përcaktuar debitori ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin dhe duke propozuar që i njëjti të shfuqizohet. Në prapësim është theksuar ndër të tjera se, asnjëherë nuk i ka pranuar vendimet e Inspektoratit të Punës dhe nuk ka pasur mundësi të ushtroj mjetin juridik ankesën.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka propozuar që Gjykata e Apelit, ta refuzojë si të pabazuar në ligj prapësimin e debitorit Komuna e Podujevës-Drejtoria e Shëndetësisë, meqë nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e paraqitura në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar me ankesë.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë gjykatësi i vetëm i Gjykatës së Apelit nuk e miraton për arsye se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave nga neni 182.1 i LPK-së lidhur me nenin 24.3 dhe 27 par.1 të LPP-së.

Neni 182.1 i LPK-së, përcakton se: "Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë".

Neni 24.3 i LPP-së, përcakton se: "Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë", ndërsa në nenin 27 par.1 të LPP-së është parashikuar që: "Dokumentet përmbarimor është i përshtatshëm

për përmbardim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit”.

Gjyqtari i vetëm gjen se, përmbardimi është caktuar në bazë të titullit ekzekutiv Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/12-88/2019 të datës 21.01.2020, në dispozitivin e të cilit nuk është cekur shuma e cila kërkohet nga kreditori. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë gjen se, nga shkresat e lëndës gjendet edhe vendimi për korrigjim por që as në këtë vendim nuk ceket shuma e cila kërkohet nga kreditori. Gjyqtari i vetëm gjenë po ashtu se, nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është konstatuar dhe vlerësuar nëse vendimi i tillë paraqet dokument përmbardues nga neni 22 dhe është i përshtatshëm për përmbardim në bazë të nenit 27 pika 1 të LPP-së.

Duke u bazuar në këto që i theksuam si më lartë, gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse nuk është i bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje përmbardimore. Për këto arsye edhe ka vendosur që pretendimet ankimore të debitorit të pranohen në tërësi si të bazuara dhe që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje

Në procedurën e serishme gjykata e shkallës së parë udhëzohet që ti eliminojë të metat si më lartë dhe të vazhdojë me procedurën sipas propozimit të parashtruar, të shikojë nëse në Vendimin Nr.01/12-88/2019 të datës 21.01.2020, është e cekur shuma e kërkuar nga ana e kreditorit, të shikojë nëse Vendimi Nr.01/12-88/2019 i datës 21.01.2020, i plotëson kushtet ligjore nga nenet 22 dhe 27 të LPP-së. Gjykata e shkallës së parë të vlerësoj edhe çështje të tjera rrethore dhe në këtë mënyrë të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje përmbardimore.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet edhe në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pika d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8367/2021 me datë 30.12.2021

GJYKATËSI,
Dr.sc. Rafet Haxhaj